



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 337/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.07.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e e ofertës së operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” ShPK dhe “Nika” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-90493-03-18-2021, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretresha Geraldine”*”, me fond limit 92,220,956 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 20.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** “KPL” ShPK  
Rruga e Dibrës, NR. 372, Ish Kuzhina, godina QSUT,  
Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin*

*dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.03.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 90493-03-18-2021, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbreteresha Geraldine*”, me fond limit 92,220,956 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 20.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 20.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dajti Park 2007	66,679,940.00	I kualifikuar
- Nika	68,479,848.00	I kualifikuar
- KPL	70,549,392.28	I kualifikuar
- Dion AI	80,550,155.00	I kualifikuar
- Sori AI	82,702,855.12	I kualifikuar

II.4. Në datën 30.04.2021 operatori ekonomik “KPL” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Kualifikimi i operatorëve ekonomikë Nika shpk dhe Dajti Park 2007 shpk është bërë në shkelje të LPP, duke qenë se këta operatorë kanë mangësi dhe parregullsi dokumentacioni të domosdoshme për kualifikimi si më poshtë:*
- *Operatori ekonomik Dajti Park 2007*
  1. *Nuk ka vërtetuar përmes vërtetimit të debisë se ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë sic kërkohet në kriterin e përcaktuar në shkronjën e të seksionit 2 kriteret e vecanta për kualifikim.*
  2. *Nuk ka dorëzuar Akt Ekspertizat e Ekspertit Kontabël të autorizuar së bashku me kopjet e verifikuara të bilanceve për vitet 2018, 2019 dhe 2020.*
  3. *Ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponon ambjent gatimi sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT shkronjat a dhe b.*
  4. *Nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar, punonjësit e paraqitur nga ofertuesi nuk figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën e kërkuar në DT dhe nuk kanë një vit eksperiencë sipas profesioneve të kërkuara. Ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për punonjësit sipas pikës 5 kapaciteti teknik në DT (kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi dhe leje drejtimi),*
  5. *Ka dorëzuar ofertë anomlaisht të ulët.*  
*Kërkojmë nga KSHA skualifikimin e OE Dajti Park 2007 shpk.*
- *Operatori Nika shpk:*
  1. *Nuk ka vërtetuar përmes vërtetimit të debisë se ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë*

2. Rezulton me detyrime tatimore të papaguara në momentin e dorëzimit të ofertës ekonomike
3. Nuk ka dorëzuar Akt Ekspertizat e Ekspertit Kontabël të autorizuar së bashku me kopjet e verifikuara të bilanceve për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
4. Nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
5. Operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponojnë ambjent gatimi sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT shkronjat a dhe b. Operatori gjithashtu nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar në shkronjën c të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT për plotësimin e standarteve tekniko teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është jashtë afatit ligjor.
6. Nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar, punonjësit e paraqitur nga ofertuesi nuk figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën e kërkuar në DT dhe nuk kanë 1 vit eksperiencë sipas profesioneve të kërkuara. Ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për punonjësit sipas pikës 5 të kapacitetit teknik në DT (kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi dhe leje drejtimi).
7. Ka dorëzuar ofertë anomalisht të ulët.  
Kërkojmë nga KSHA skualifikimin e OE Nika shpk.

II.5. Në datën 07.05.2021 me shkresën nr.838/2 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 17.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.960/1 prot datë 02.06.2021 protokolluar me tonën me nr.840/2 prot datë 04.06.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se “Nuk ka vërtetuar

*përmes vërtetimit të debisë se ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*e.Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumnetacionin si më poshtë:

- Vërtetim Debie Nr.308 prot datë 23.03.2021 me përmbajtje si vijon: Bazuar në deklaratimet e deklaruesit z SH.Nika vërtetojmë se kërkuesi Nika shpk nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën me kod XXXXXXXX titullar i së cilës është Nika shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 23.03.2021 përfshirë faturën koherente të muajit Shkurt 2021.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet : *[...]Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasteve kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i*

*detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.1.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*”, përcaktohet shprehimisht që: “*Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.1.7. Referuar korenspondencës mbajtur midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nga kjo e fundit është konfirmuar se, pasi bëhen verifikimet përkatëse në sistemin e faturimit, lëshohet “*Vërtetim Debie*” sipas formatit standart për të gjitha subjektet aplikuese. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike, evidenton saktësinë e dokumentacionit, të paraqitur nga subjektet përkatëse si dhe tërësine e kontratave, dhe në fund konkludon me lëshimin e “*Vërtetim Debisë*” i cili konfirmon se:

1. *Konsumatori nuk rezulton debitor në sistemin e furnizimit*
2. *Konsumatori rezulton debitor*
3. *Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*

III.1.8. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk ka dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike referuar datës së zhvillimit të procedurës, duke plotësuar kështu kriterin e vecantë të kualifikimit në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se “Rezulton me detyrime tatimore të papaguara në momentin e dorëzimit të ofertës ekonomike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

c) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

ç) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

**d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.**

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

***Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.***

***Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.***

***Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.***

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kritereve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në 12.04.2021, nga Autoriteti*

*Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbreteresha Geraldine”, me fond të marrëveshjes kuadër: 92,220,956 (nëntëdhjetë e dy milion e dyqind e njëzetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).*

*Unë i nënshkruari Shpresa Nika me cilesinë Drejtuesit ligjo të operatorit ekonomik “NIKA” Shpk deklaroi nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik “NIKA” Shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarohet se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

- *Operatori ekonomik “NIKA” Shpk nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*
- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Emër (Emrat) Mbiemër Datëlindje ditë muaj vit Atësi Amësi Vendlindje 1 Shpresa Nika 11.04.1973 Pjeter Line Shkoder nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP1 .*

- *Operatori ekonomik “NIKA” Shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

- *Operatori ekonomik “NIKA” Shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*

- *Operatori ekonomik “NIKA” Shpk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

- *Vërtetim për pagim detyrimesh Nr.T03829149 datë 02.04.2021 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve me anë të së cilës vërtetohet se tatimpaguesi Nika shpk rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 02.04.2021.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;



Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.2.4. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.5. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk ka dorëzuar deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit ku është deklaruar ndër të tjera se operatori ekonomik “NIKA” Shpk, ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër. Gjithashtu rezulton se është paraqitur dokumenti vërtetim për pagim detyrimesh Nr.T03829149 datë 02.04.2021 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve me anë të së cilës vërtetohet se tatimpaguesi Nika shpk rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 02.04.2021 duke plotësuar kështu kriterin e përgjithshëm të kualifikimit në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se *“Nuk ka dorëzuar Akt Ekspertizat e Ekspertit Kontabël të autorizuar së bashku me kopjet e verifikuara të bilanceve për vitet 2018, 2019 dhe 2020’*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2018, 2019, 2020 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumnetacionin si më poshtë:

- Pasqyrat financiare për vitin 2018 shoqëruar me raportin e audituesit ligjor për periudhën 1 Janar 2018-31 Dhjetor 2018).
- Pasqyrat Financiare për vitin 2019 shoqëruar me raportin e audituesit ligjor për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2019.
- Pasqyrat Financiare për vitin 2020 shoqëruar me raportin e audituesit ligjor.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.3.4. Në nenin 27 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik parashikohet:

*5. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose b) “kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Nika shpk rezulton se ky i fundit ka paraqitur kopje të pasqyrave financiare të certifikuara nga administrata tatimore të shoqëruara me raportin e audituesit ligjor për tre vitet e fundit në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit dhe aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se *Nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për shërbimet e meparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:*
  - a) *Kur për shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes.*
  - b) *Kur për shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë NR. 5058/13 datë **01.08.2016** lidhur nëpërmjet Repartit Ushtarak nr. 4001 dhe shoqërisë “Nika” shpk me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (catering) Loti X për nevoja të Reaprit Ushtarak nr. 4001 Vaqar PezëRrapi i Treshit Babru Tiranë”, me vlerë: 118.789.931 lekë pa TVSH dhe 142.547.917 lekë me TVSH bashkëlidhur: Aneks nr. 1 (tabela e normave të detajuar për artikuj).
- Kontratë shtesë shërbimi nr. 1806/6 datë 30.03.2020 lidhur nëpërmjet Komandës Mbështetëse Reparti Ushtarak nr. 4001 Tiranë dhe shoqërisë “Nika” shpk me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (catering) Loti X për nevoja të Reaprit Ushtarak nr. 4001, Komanda Mbështetëse, Vaqarr, Tiranë me vlerë 19.182.400 lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore shitjeje nr. 79 datë 09.04.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.260.400,6 lekë pa tvsh**
- Faturë tatimore shitjeje nr.101 datë 03.05.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.399.797,6 lekë pa tvsh**
- Faturë tatimore shitjeje nr.128 datë 04.06.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.364.704,8 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.146 datë 02.07.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **956.382 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.172 datë 31.08.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.034.512,8 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.184 datë 07.09.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **838.358,6 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.206 datë 19.10.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte **941.864,4 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.226 datë 05.11.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **957.253 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.26 datë 13.12.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.007.069,2 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.29 datë 13.12.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **161.254,17 lekë pa tvsh**

- Faturë tatimore shitjeje nr.12 datë 23.01.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **849.860,4 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.37 datë 19.02.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **912.790,8 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.55 datë 13.03.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **928.454,2 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.77 datë 03.04.2018, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.052.396,2 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.94 datë 01.05.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.287.386,4 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.124 datë 18.06.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **1.457.024 lekë pa tvsh.**
- Faturë tatimore shitjeje nr.145 datë 05.07.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **233.592 lekë pa tvsh.**
- Faturë Tatimore Nr.146 datë 05.07.2019 me pershkrim rivlerësim kontrate sipas normës së inflacionit me vlerë 888,324 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Nr.150 datë 16.07.2019 me vlerë 1,182,548 lekë pa tvsh
- Faturë tatimore shitjeje nr. 446 datë 01.08.2019, përshkrimi mallit shërbimit shërbim gatimi dhe shpërndarje një vakt si dhe shërbim gatimi dhe shpërndarje tre vakte me vlerë **859.065 lekë pa tvsh.**
- Faturë Tatimore Shitje Nr.476 datë 17.02.2019 me vlerë 836,057 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.168 datë 07.10.2019 me vlerë 1,057,370 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.184 datë 11.11.2019 me vlerë 1,157,708 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.188 datë 02.12.2019 me vlerë 1, 690,745 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.2 datë 06.01.2019 me vlerë 2,077,352.6 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.12 datë 04.02.2020 me vlerë 955,704 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.18 datë 08.02.2020 me vlerë 997,911 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.21 datë 06.04.2020 me vlerë 786,216.8 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.24 datë 05.05.2020 me vlerë 591,369 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.41 datë 05.06.2020 me vlerë 650,624 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.51 datë 06.07.2020 me vlerë 1,164,799 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.62 datë 07.05.2020 me vlerë 1,093,240 lekë pa tvsh
- Faturë Tatimore Shitje Nr.76 datë 30.09.2020 me vlerë 625,801.6 lekë pa tvsh

- *Faturë Tatimore Shitje Nr.78 datë 05.10.2020 me vlerë 860,944,8 lekë pa tvsh*
- *Faturë Tatimore Shitje Nr.101 datë 10.11.2020 me vlerë 607,724.8 lekë pa tvsh*
- *Faturë Tatimore Shitje Nr.810 datë 03.12.2020 me vlerë 594,812.8 lekë pa tvsh*
- *Faturë Tatimore Shitje Nr.132 datë 31.12.2020 me vlerë 619,776 lekë pa tvsh*
  
- *Kontratë shërbimi nr. 3 prot., datë 05.06.2020 lidhur nëpërmjet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Reparti Special për Kufirin dhe Migracionin “Delta” dhe “Nika” shpk me objekt: Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Reartin Special për Kufirin dhe Migracioni “Delta” Radhimë-Vlorë”, me vlerë 17.387.464 lekë pa TVSH bashkëlidhur:*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 46 datë 30.06.2020, me vlerë 325.787,18 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 54 datë 09.07.2020, me vlerë 390.802 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 65 datë 21.08.2020, me vlerë 392.135 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 71 datë 07.09.2020, me vlerë 373.417,64 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 97 datë 02.11.2020, me vlerë 350.349,56 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 111 datë 02.12.2020, me vlerë 368.925,37 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 115 datë 14.12.2020, me vlerë 113.760,6 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë tatimore shitjeje nr. 131 datë 31.12.2020, me vlerë 276.459,26 lekë pa tvsh.*
  
- *Kontratë shërbimi nr. 3014 prot datë 31.12.2020 lidhur nëpërmjet Spitalit Rajonal Shkodër dhe “Nika” shpk, me objekt : Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Shkodër me vlerë kontrate 9.874.056 lekë pa tvsh, bashkëlidhur faturë elektronike kodi 388 numri i faturës 28/2021, me vlerë 3.069.459 lekë pa tvsh.*
  
- *Kontratë shërbimi nr. 1638 prot datë 29.07.2020 lidhur nëpërmjet Spitalit Rajonal Shkodër dhe “Nika” shpk, me objekt : Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Shkodër me vlerë kontrate 6.012.274 lekë pa tvsh, bashkëlidhur*
  - *Faturë Tatimore Shitje Nr. 120 datë 14.12.2020 me vlerë 2.720.053 lekë pa tvsh.*
  - *Faturë Tatimore Shitje Nr.130 datë 31.12.2020, me vlerë 868.507 lekë pa tvsh.*
  
- *Kontratë Furnizimi datë 01.01.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Nika shpk de Junik shpk me objekt Furnizim me ushqim catering me vlerë 12,000,000 lekë pa tvsh*
- *Faturë Tatimore Shitje Nr.361 datë 18.12.2019 me përshkrim shërbim catering me vlerë 12,000,000 lekë pa tvsh.*

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë

*vertetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet :

*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

III.4.5. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin kontrata të ngjashme në vlerë totale prej jo më pak se 40 % e fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë: Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat

tatimore të shitjes. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Nika shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri janë dorëzuar kontrata të lidhur me ent publik së bashku me faturat tatimore të shitjes ku dëshmohet se operatori ekonomik plotëson kushtet ligjore lidhur me ngjashmërinë e furnizimeve të kryera, në një vlerë që tejkalon 40 % e fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se *“Operatori ekonomik ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponojnë ambjent gatimi sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT shkronjat a dhe b. Operatori gjithashtu nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar në shkronjën c të nënpikës 2 të pikës 3.3 kapaciteti teknik të DT për plotësimin e standarteve tekniko teknologjike për ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Certifikata për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin është jashtë afatit ligjor”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3/2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. *Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

a) *Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:*

➤ ***Dokumentacioni që vërteton pronësinë:***

- *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ ***Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:***

- *Kontratë huaje.*

➤ ***Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:***

- *Kontratë qiraje.*

b) *Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.*



c) *Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standarteve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.*

III.5.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumnetacionin si më poshtë:

- *Certifikatë për Vërtetim Pronësie . Lloji i pasurisë truall. Sipërfaqe trualli 4890 m2 , nga kjo Sipërfaqe ndërtesë 1100 m2.*
- *Certifikatë për sigurinë nga zjari Nr.66/3 prot datë 05.02.2021*
- *Certifikatë DDD*
- *Akt Miratimi Higjens Sanitar Nr.31.*
- *Leje Mjedisore Kodi III.1.A*
- *Deklaratë me anë të së cilës deklarohet se: Disponojmë ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi si dhe stafin e kërkuar sipas DT. Gjithashtu deklarojmë se ky ambient me infrastrukturën , mjetet dhe pajisjet që disponon i plotëson standartet tekniko teknologjike për veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.*

III.5.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.5.3. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.5.4. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.5. Referuar sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektornike rezulton se operatori ekonomik Nika shpk me dokumentacionin e dorëzuar dëshmon se disponon një ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit sipas kërkesave në kriterin e vecantë të kualifikimit. KPP vëren se operatori ekonomik Nika shpk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit konkretisht Certifikatë për Vërtetim Pronësie . Lloji i pasurisë truall. Sipërfaqe trualli 4890 m<sup>2</sup> , nga kjo Sipërfaqe ndërtesë 1100 m<sup>2</sup>, Certifikatë për sigurinë nga zjari Nr.66/3 prot datë 05.02.2021 lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj, Deklaratë me anë të së cilës deklarohet se: Disponojmë ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit objekt prokurimi si dhe stafin e kërkuar sipas DT. Gjithashtu deklarojmë se ky ambient me infrastrukturën , mjetet dhe pajisjet që disponon i plotëson standartet tekniko teknologjike për veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit si dhe Certifikatë DDD, Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.31, Leje Mjedisore Kodi III.1.A. Sa i takon pretendimit të ankimesit se certifikata e mbrojtjes nga zjarri e paraqitur nga operatori ekonomik Nika është jashtë afatit ligjor, KPP vëren se certifikata mban datën 05.02.2021. Referuar Ligjit Nr.152/2015 PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN parashikohet se : “Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri” është akti administrativ, i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve. Në fund të certifikatës së paraqitur nga operatorit ekonomik Nika shpk citohet shprehimisht se: Certifikata e sigurisë nga zjarri ka afat 5 vjeçar. Në këtë Kuptim KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit lidhur me ambientin e gatimit është i plotë dhe i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se *Nuk plotëson numrin e të punësuarve të kërkuar në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar, punonjësit e paraqitur nga ofertuesi nuk figurojnë në listpagesën e shoqërisë për periudhën e kërkuar në DT dhe nuk kanë 1 vit eksperiencë sipas profesioneve të kërkuara. Ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për punonjësit sipas pikës 5 të kapacitetit teknik në DT (kontratë pune, librezë pune, librezë shëndetësore, diplomë ose certifikatë kualifikimi dhe leje drejtimi)*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3/4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*4.Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 16 (njëmbëdhjetë) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit, të siguruar për periudhën Dhjetor 2020- Shkurt 2021. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Dhjetor 2020- Shkurt 2021.*
- *Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Dhjetor 2020- Shkurt 2021;*

*4.1 Punonjësit e punësuar në sektorin e shërbimit të ushqimit duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:*

<i>Nr.</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Numri i punonjesve</i>
<i>1</i>	<i>Kuzhinier</i>	<i>4</i>
<i>2</i>	<i>Mercollog/Kimist/teknolog</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	<i>Ndihmes kuzhinierë/Shërbyes gatimi</i>	<i>9</i>
<i>4</i>	<i>Shofer</i>	<i>1</i>
	<b><i>Total</i></b>	<b><i>16</i></b>

*Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, librezë pune, librezë shëndetsore.*
- b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, librezë pune, librezë shëndetsore.*
- c) Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontrata pune dhe librezat e punes, librezë shëndetsore.*
- d) Për shoferin: kontratë pune, librezë pune dhe leje drejtimi mjeti kategoria – B.*

e) *Punonjësit me profesionet e mësipërme duhet të figurojnë në listpagesat e operatorit ekonomik për periudhen e kerkuar.*

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik Nika shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Petrit Marku, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
2. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Xhesjan Shehu, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
3. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Sander Nika, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
4. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Erjon Stermollli, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
5. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Marina Perzefi, në profesionin si ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
6. Librezë pune për Z. Ervis Lita.
7. Librezë pune për Znj. Fabiola (Fushazi) Dushkja.
8. Librezë pune për Znj. Mira Shehu.
9. Librezë pune për Znj. Shpresa Nika.
10. Librezë pune për Znj. Gjeline Gjergj Qukaj.
11. Librezë pune për Znj. Fabiola Fushazi.
12. Librezë pune për Z. Petrit Marku.
13. Librezë pune për Z. Xhesjan Shehu.
14. Librezë pune për Z. Sander Nika.
15. Librezë pune për Z. Erjon Stermollli.
16. Librezë pune për Znj. Marina Perzefi.
17. Librezë shëndetësore për Znj. Marina Perzefi.
18. Librezë shëndetësore për Z. Erjon Stermollli.
19. Librezë shëndetësore për Z. Sander Nika.
20. Librezë shëndetësore për Z. Xhesjan Shehu.
21. Librezë shëndetësore për Z. Petrit Marku.
22. Librezë shëndetësore për Znj. Fabiola Fushazi.
23. Librezë shëndetësore për Z. Ervis Lita.
24. Librezë shëndetësore për Znj. Gjeline Qukaj.
25. Librezë shëndetësore për Znj. Mira Shehu.
26. Librezë shëndetësore për Znj. Shpresa Nika.
27. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Fran Kasneci, në profesionin specialist sipas kualifikimeve që disponon, pa afat.

28. ID, Leje drejtimi dhe Librezë pune për Z. Fran Kasneci.
29. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Aldo Demaj, në profesionin specialist sipas kualifikimeve që disponon, pa afat.
30. ID, Leje drejtimi dhe Librezë pune për Z. Aldo Demaj.
31. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Benet Ndoci, në profesionin specialist sipas kualifikimeve që disponon, pa afat.
32. ID, Leje drejtimi, Certifikatë e Aftësisë profesionale nga DPSHTRR dhe Librezë pune për Z. Benet Ndoci.
33. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Etleva Sadiku, në profesionin kimist-teknolog ushqimor, pa afat.
34. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Ardit Ahmeti, në profesionin kimist-teknolog ushqimor, pa afat.
35. Diplomë për Znj. Etleva Sadiku, në profesionin kimist-ushqimor, Cv, Librezë pune dhe Librezë shëndetësore.
36. Diplomë për Z. Ardit Ahmeti, në profesionin kimist-ushqimor, certifikatë notash, ID, Librezë pune dhe Librezë shëndetësore.
37. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Klea Bilali, në profesionin nutricioniste dhe dietologe, me afat kohor 6-mujor.
38. Shkresë nga Rektori i Universitetit Trakya, Dekanati i Fakultetit të Shkencave Shëndetësore datë 24.09.2020 për edukimin-arsimimin e Znj. Klea Bilali, (e përkthyer/noterizuar).
39. Librezë pune, Librezë shëndetësore dhe Raporti i aftësisë në punë për Znj. Klea Bilali.
40. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Arben Mustafa, në profesionin kuzhinier, pa afat, Cv, Librezë pune, ID, Librezë shëndetësore dhe Dëshmi Kulaifikimi nga Shkolla e Ushqimit Social-Tiranë.
41. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Arben Hasa, në profesionin kuzhinier, pa afat.
42. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Xhevrije Sinani, në profesionin kuzhinier, pa afat dhe Librezë pune.
43. Certifikatë me nr.amze 087, datë 20.04.2017 për Z. Arben Hasa, nga Qendra e Formimit Profesional Privat “Edmond Sala”, pasi ka përfunduar kursin 9 (nëntë) mujor, për kuzhinier, Librezë shëndetësore dhe Librezë pune.
44. Certifikatë me nr.amze 232, datë 20.12.2019 për Znj. Xhevrije Sinani, nga Qendra e Formimit Profesional Privat “Edmond Sala”, pasi ka përfunduar kursin 6 (gjashtë) mujor, për kuzhinier dhe Librezë shëndetësore.
45. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Trashe Martini, në profesionin kuzhinier, me afat 6 muaj, Dëshmi Kualifikimi me nr. 28 nga Kursi i Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit Shkodër, Librezë pune, Librezë shëndetësore .

46. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 04.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Nimoze Sofi, në profesionin kuzhinier, me afat 6 muaj, Dëshmi Kualifikimi me nr. 21 nga Kursi i Ministrisë së Tregtisë dhe Turizmit Shkodër, Vërtetim nga Shkolla e Mesme Shkodër që ka përfunduar vitin shkollor 1985-86 shkollën e mesme të ndërtimit, dega ndërtim, Librezë pune, Librezë shëndetësore, raporti i Aftësisë në punë.
47. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Marsel Trasha, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
48. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Lule Fushazi, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
49. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Marije Kola, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
50. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Ladimir Marku, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
51. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Alfons Gjellaj, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
52. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Sokol Qetaj, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
53. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Emanuel Nika, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
54. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Gjoka Skollaj, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
55. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Gëzim Qetaj, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
56. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Gjovan Fushazi, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
57. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Hektor Marku, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat, Librezë pune, Librezë shëndetësore.
58. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Shpresa Nika, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.

59. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Mira Shehu, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
  60. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Gjeline Qukaj, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
  61. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Znj. Fabiola Dushkja, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
  62. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Ervis Lita, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
  63. Kontratë pune (e-rinovuar), datë 05.01.2021 midis shoqërisë “NIKA” SHPK dhe Z. Fabjan Fushazi, në profesionin ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, pa afat.
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Dhjetor 2020- Shkurt 2021

III.6.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.6.4 Neni 28, pika 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *“5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV të tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.6.5. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” shpk rezulton se disponon në stafin e tij punonjës me kualifikimet dhe eksperiencën e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit. Konkretisht operatori ekonomik Nika shpk me dokumentacionin e paraqitur diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, libeze pune, librezë shëndetsore si dhe leje drejtimi, dëshmon se disponon një numër punonjëish që tejkalon numrin e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit për punonjës me profesion kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier. Akoma më tej operatori ekonomik plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor lidhur me 2 punonjës me profesion Mercollog/Kimist/teknolog si dhe për një punonjës me profesion shofer. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm dhe në përputhje me kërkesat në kriterin e kualifikimit për punonjësit sipas profileve të kërkuara. Gjithashtu punonjësit si më sipër rezultojnë në listagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar Dhjetor 2020-Shkurt 2021.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Nika” SHPK me argumentin se *Ka dorëzuar ofertë anomalisht të ulët*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në datën 27.04.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dajti Park 2007	66,679,940.00	I kualifikuar
- Nika	68,479,848.00	I kualifikuar
- KPL	70,549,392.28	I kualifikuar
- Dion Al	80,550,155.00	I kualifikuar



III.7.2. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.7.3. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në **rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.** Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.7.4. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe veriifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në procedurën e prokurimit objekt ankimi janë kualifikuar 5 operatorë ekonomikë. Neni 66 i VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, sikundër në rastin konkret ofertë anomalisht e ulët do të konsiderohet ajo ofertë vlera e së cilës është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Në rastin konkret vlera e ofertës pas aplikimit të formulës 85% të mesatares së ofertave të vlefshme në procedurën e prokurimit objekt ankimi rezulton të jetë 62,723,572 lekë. Ndërkohë operatori

ekonomik Nika shpk ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi me cmimin 68,479,848.00 lekë pa tvsh. Në këtë kuptim, KPP gjykon se oferta e operatorit ekonomik Nika shpk nuk konsiderohet ofertë anomalisht e ulët pasi nuk përmbush kushtet e parashikuara në nenin 66 të VKM 914/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “KPL” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitetit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Për sa kohë që pas shqyrtimit të pretendimeve të ankimuesit mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nika”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykoj se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në këtë mënyrë ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 27.04.2021 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik “Nika” ShPK mbetet e kualifikuar, pretendimet e tjera të palës ankimuese për skualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrative, pasi cilido qoftë fati i pretendimeve të tyre, pala ankimuese nuk mund të arrijë dot qëllimin e saj final të fitimit të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues KPL shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19 njëzëri

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KPL” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-90493-03-18-2021, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretresha Geraldine”*”, me fond limit 92,220,956 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 20.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 840 Protokoli; Datë 17.05.2021.**

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**